Udhëzues për përdorimin e aplikacionit "eHidrodrini"

Regjistrimi

Hapi 1: Shkarkimi dhe instalimi i aplikacionit "eHidrodrini"

Aplikacionin "eHidrodrini" mund ta shkarkoni nga dyqanet: "Apple AppStore" për pajisjet me sistem operativ "iOS" si dhe "Google Play Store" për pajisjet me sistem operativ "Android".

Hapi 2: Navigimi te "butoni": Regjistrohuni

Pasi që ta keni shkarkuar dhe instaluar aplikacionin, mund ta hapni atë dhe pasi që ta keni hapur për ta përdorur fillimisht duhet të regjistroheni duke klikuar në "butonin"; <u>Regjistrohuni</u> (i shënjuar me ngjyrë të kuqe) sikurse në figurën 1.

ermes eHi	idrodrinit, KRU mundëson:	Hidrodrini ju
🏠 Regjistri	imin e pronave t	Jaja
Monitori	imin e shpenzim	eve
P agesa	të sigurta online	
Emriine	ardoruesit	
Linitipe	sidoidesit	
Fjalëkali	imi	ଷ
Fjalëkali	imi Kyçu	2
Fjalëkali	imi Kyçu i harruar fjalëkal	Re limin2
Fjalëkali Ken	imi Kyçu i harruar fjalëkal	imin?

Figura 1: "Butoni" Regjistrohuni.

Regjistrohu

& Emri*

& Mbiemri*

M Email*

Hapi 3: Vendosja/shkruarja e të të dhënave

Pasi që të keni klikuar mbi "butonin": "Regjistrohuni" nga hapi paraprak, do të hapet një formularë sikur në figurën 2, në të cilin duhet të vendosni/shkruani të dhënat e juaja të sakta.

Të dhënat e domosdoshme janë të shënjuara me yll "*", pra këto duhet më patjetër që të plotësohen dhe duhet të jenë të sakta. Gjithashtu e-mail adresa e juaj duhet të jetë funksionale.

Te numri i faturës duhet të vendosni/shkruani numrin e saktë nga cilado fakturë që e keni pranuar gjatë vitit 2025 (si shembull dhe lokacionin se ku mund ta gjeni këtë numër mund ta shihni në figurën 3 në vazhdim).



8	Numri Personal
	Numri i Telefonit
E	Numri i Faturës*
٩	Emri i Përdoruesit*
∂	Fjalëkalimi*
	Regjistrohu
	Keni llogari? Kyçu

Figura 2: Formulari për regjistrim.

Figura 3: Lokacioni i numrit të faturës suaj.

Pasi që t'i keni vendosur/shkruar të dhënat e juaja të sakta, klikoni në "butonin": Regjistrohu, dhe nëse i keni plotësuar të gjitha fushat e domosdoshme do të paraqitet në ekran një njoftim sikur në figurën në vazhdim.



Figura 4: Njoftimi për plotësimin e të dhënave të domosdoshme

Hapi 4:

Pasi që është paraqitur në ekran njoftimi: Sukses, sikurse në figurën e mësipërme, duhet të kontrolloni në e-mailin tuaj të cilin e këni shënuar gjatë regjistrimit (në: "inbox", "spam" ose "junk") për një e-mail përmes së cilit duhet ta konfirmoni e-mail adresën tuaj, sikurse në figurën në vazhdim.



Figura 5: E-maili i dërguar nga sistemi për konfirmim

Pasi që ta hapni këtë e-mail, do të paraqitet përmbajtja në vazhdim dhe ju duhet të shtypni "butonin": Konfirmoni E-mail-in Tuaj, përmes së cilit e konfirmoni e-mailin tuaj dhe kështu aktivizohet llogaria e juaj në aplikacionin "eHidrodrini". (Shënim: në rast se ky "buton" i konfirmimit nuk shtypet/funksionon këtë e-mail duhet ta bartni në "inbox" pra ta konsideroni sikurse e-mail të sigurtë dhe mandej do të funksionojë pra mund ta shtypni).



Figura 6: "Butoni" për konfirmimin e e-mail adresës,

Me këtë përfundon edhe procesi i regjistrimit dhe që nga ky moment mund ta përdorni aplikacionin "eHidrodrini" në pajisjen tuaj mobile.

Përdorimi i aplikacionit

Përdorimi i aplikacionit është i vetkuptueshëm dhe shumë praktik.

Kyçja (login) në aplikacion bëhet duke vendosur/shkruar të dhënat siç i keni dhënë gjatë fazës së regjistrimit, në fushat: "Emri i përdoruesit" dhe "Fjalëkalimi" dhe duke shtypur "butonin": Kyçu.

Emri i Përdoruesit*	1710 5 + 6
🗗 Fjalëkalimi*	HIDRODRINI
Regjistrohu	Përmes eHidrodrinit, KRU Hidrodrini ju mundëson:
Figura 7. të dhënat gjatë regjistrimit	🏠 Regjistrimin e pronave tuaja
	📊 Monitorimin e shpenzimeve
	💳 Pagesa të sigurta online
	Emri i perdoruesit Fjalëkalimi 🔌
	Kyçu
	Keni harruar fjalëkalimin?

Figura 8: Të dhënat e kyçjes (nga figura 7)

Ndërfaqja 1: Ballina

Pasi që të jeni kyçur me të dhënat e juaja, paraqitet ndërfaqja e parë e programit e quajtur: Ballina.

Në këtë ndërfaqe mund të shihni detajet e juaja sikurse:

- Emri dhe Mbiemri, _
- Numri serik i ujëmatësit tuaj,
- Numri i juaj i konsumatorit, _
- Borxhi total (i përgjithshëm)
- Vlera e faturës së fundit
- Vlera dhe data e pagesës së fundit e kryer nga ju,
- _ Sasia dhe data e faturimit të fundit,
- Grafikën që paraqet konsumin sipas muajve, si dhe _
- "Butonin": Paguaj për të kryer pagesë "online"





Figura 9: Ballina

"Butoni": Paguaj dhe procesi i kryerjes dhe konfirmimit të pagesës

Nëse shtypni "butonin" paguaj, do të paraqitet kjo figurë (figura 10) në të cilën ofrohet mundësia që ta paguani borxhin në tërësi (sikurse në figurë në vlerë prej 24.24 Euro) apo edhe fusha tjetër nën të, në të cilën mund ta shkruani vlerën të cilën dëshironi ta paguani, e pastaj shtypni "butonin": Vazhdo.

Pasi që ta keni shtypur "butonin" vazhdo do të paraqitet ndërfaqja e Bankës BKT sikurse në figurën 11 në të cilën duhet t'i shkruani shënimet që gjenden në kartelën tuaj të bankës me të cilën dëshironi të kryeni pagesën.

Shënim: Kompania K.R.U. "Hidrodrini" SH.A. – Pejë ka marrëveshje me bankën BKT dhe merr përsipër shpenzimet e transaksioneve bankare me rastin e pagesës "online" për konsumatorët e vet. Pra, ju sigurojmë se për ju, me rastin e pagesës përveç vlerës që e caktoni ju për pagesë nuk krijohen shpenzime bankare shtesë.

Pasi që i keni plotësuar fushat e nevojshme duhet të shtypni "butonin": "Submit"



Figura 10: Vlera për pagesë

4

Pagesë e Borxhit Emri Mbiemri Kartembaitesit **FILAN FISTEKU** Numer karte 1234 1234 1234 1234 Emri i tregtarit: K.R.U HIDRODRINI SHA Numri i kesteve: Pagesë e Vetme 🗸 Totali 3.00 EUR Submit

Figura 11: Të dhënat e kartelës bankare

Pasi që keni shtypur "butonin": "Submit" në ekran paraqitet kërkesa nga sistemi i bankës për të konfirmuar pagesën përmes "SMS". Duhet të shtypni "butonin": Dërgo SMS.







Konfirmimi i blerjes

Për sigurinë e kartës tuaj, duhet të konfirmoni pagesën (15.06.2025, K.R.U HIDRODRINI SHA) me një kod një përdorimësh (K1P).

Mesazhi që permban kodin do dërgohet në numrin tuaj të telefonit regjistruar në bankë (38349XXX123) Ju lutemi klikoni në butonin 'Dërgo kodin (K1P)' për të marrë këtë kod.



Mëso më shumë rreth authentikimit + Keni nevojë për ndihmë? +

Figura 12: Kërkesa për konfirmim përmes SMS

Pasi që ta pranoni kodin me SMS sikurse në figurën 13 duhet

ta shënoni atë në kutinë sikurse në figurën 13 dhe të shtypni

"butonin": Konfirmo.



Për çështje sigurie, duhet të vërtetoni pagesën tuaj (pagesa 3,00 EUR në 15.06.2025 për K.R.U HIDRODRINI SHA) me një kod.

Ju lutemi vendosni kodin që keni pranuar në numrin tuaj 38349XXX123 në mënyrë që të vërtetoni se jeni kartëmbajtësi.



+

Figura 13: Kutia për kodin nga SMS

Nëse çdo gjë shkon në rregull, do të pranoni konfirmimin nga sistemi për kryerjen e pagesës me sukses sikurse në figurën 14 në vazhdim. \leftarrow Pagesë e Borxhit

Njoftime me rëndësi:

- Për shkaqe sigurie: kohezgjatja e plotësimit të të dhënave, kohëzgjatja e pranimit dhe shënimit të konfirmimit është e kufizuar sipas përcaktimeve nga Banka.
- Pagesat janë të sigurta, sepse kemi garanci nga Banka dhe Kompania Informatika programin e të cilës ne e kemi në përdorim, e gjithashtu konfirmojmë se sistemet janë testuar para se të jenë publikuar.
- 3. Për momentin pagesat nga Aplikacioni "eHidrodrini" nuk sinkronizohen në mënyrë automatike, në sistemin tonë. Jemi duke punuar ngushtë me Kompaninë Informatika që ta jetësojmë këtë sa më shpejtë që të jetë e mundur. Pagesat aktualisht, regjistrohen pasi që i pranojmë deklaratat për transaksionet e vërtetuara nga Banka, pra një periudhë kohore maksimale deri në 5 ditë.



Figura 14: Konfirmimi i transaksionit

Ndërfaqet 2, 3 dhe 4

Te ndërfaqja **"Faturat"** mund të shihni datën e faturimit si dhe vlerën e secilës faturë në Euro sipas muajve,

Te ndërfaqja **"Pagesat"** mund të shihni të gjitha pagesat e kryera (pasi që të jenë regjistruar nga ne) gjatë vitit 2025.

Te ndërfaqja **"Konsumi"** mund të shihni: Datën e faturimit të ujëmatësit, vlerën e leximit në m3 të sasisë paraprake dhe të tanishme të konsumit për secilin muaj.





Ndërfaqja 5: Opcionet

Te ndërfaqja: Opcionet janë katër (4) "butona":

1. Ndrysho fjalëkalimin

I cili ju mundëson që në mënyrë të drejtpërdrjetë ta ndryshoni fjalekalimin tuaj.

2. Lista e ujëmatësve

E cila për momentin nuk është funksionale. Kemi kërkuar nga Kompania Informatika dhe jemi duke bashkëpunuar ngushtë që ta funksionalizojnë këtë funksion dhe ta krijojmë mundësinë që konsumatorët të mund t'i regjistrojnë në një llogari brenda aplikacionit të gjithë ujëmatësit që i posedojnë. Presim që për një kohë të shkurtër edhe kjo të funksionalizohet.

3. Njoftimet

Edhe për njoftimet është duke u punuar. Ideja është që

konsmatorët të pranojnë njoftime për:

- faturat e tyre sapo që ato të përgatiten,
- të pranojnë njoftime për afatet e pagesave,
- versionet e reja dhe të rejat rreth aplikacionit mobil,
- etj.

17:18 @ ⊕ @ • OI	യപപ 🕢		
HIDR O DRINI Kompania Rajonale e Ujësjelikist "HiDRODRINI" Sh.A.			
۵	Filan Fisteku		
Ndrysho Fjalekalimin	Lista e Ujëmatësve		
Njoftimet	⊡ Dilni		
Ballina Faturat	Pagesat Konsumi Opcionet		
111	0 <		